


| | |
|--|----------------------------|
| REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA/REPUBLIC OF KOSOVO | |
| AGJENCIA KUNDËR KORRUPSIONIT AGENCIA PROTIV KORRUPCIE ANTI-CORRUPTION AGENCY | |
| Dep. 2-0/OPK | Bi Prot. 01-4523/15 |
| Dep. 04 | Prot No 01-4523/15 |
| Nr. i faq | Data |
| Broj stranica | Datum |
| Nr. pages | Date 01.12.2015 |
| PRISHTINE | |



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo

AGJENCIA KUNDËR KORRUPSIONIT
AGENCIA PROTIV KORRUPCIE
ANTI - CORRUPTION AGENCY

| | |
|-------------------------------|---|
| DATË/A: | 01/12/2015 |
| REFERENC-Ë: | AKK-DPK- DPKPP |
| PËR/ZA/TO: | z. Tahir DEMIRAJ Menaxher i Prokurimit në Shërbimin Korrektues të Kosovës- Ministria e Drejtësisë |
| CC: | z. Eset RAMA Sekretar i Përgjithshëm në Ministrinë e Drejtësisë |
| NGA/OD/FROM: | Hasan PRETENI Drejtor i Agjencisë kundër Korrupsionit |
| TEMA/SUBJEKAT/SUBJECT: | Opinion lidhur me tenderin: "Furnizim me mish dhe produkte të mishit" |

I nderuar z. Demiraj,

Në mbështetje të nenit 142 par. 3 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, nenit 5 par. 1, nënpar. 1.1. dhe 21 të Ligjit nr. 03/L-159 për Agjencinë kundër Korrupsionit, nenit 8 par. 4, 9 par. 1, nënpar. 1.6, 12 par. 2 dhe 19 par. 1, nënpar. 1.6 të Ligjit nr. 04/L-051 për Parandalimin e Konfliktit të Interesit në Ushtrimin e Funkcionit Publik, si dhe të nenit 23 të Rregullores nr. 01/2014 së Punës së Agjencisë kundër Korrupsionit, lidhur me Tenderin lidhur me Tenderin "Furnizim me mish dhe produkte të mishit" me numër prokurimi 21500 15 024 111, Agjencia kundër Korrupsionit, ofron këtë:

OPINION

Në lidhje me Tenderin Publik: "Furnizim me mish dhe produktet të mishit" me numër të prokurimit: 21500 15 024 111, në mënyrë që të procedohet në pajtim me dispozitat përkatëse të Ligjit nr. 04-L/42 për Prokurimin Publik dhe të akteve tjera nënligjore që derivojnë nga ky ligj.

A r s y e t i m

Autoriteti Kontraktues, Ministria e Drejtësisë – Shërbimi Korrektues i Kosovës, bazuar në nevojën për **Furnizim me mish dhe produkte të mishit**, ka paraparë aktivitet prokurimi me Procedurë të Hapur. Aktiviteti i prokurimit në Komisionin Rregullativ të Prokurimit Publik është shpallur më datë: 15/10/2015.

Sipas detyrës zyrtare Agjencia kundër Korrupsionit, njofton Autoritetin Kontraktues- Ministria e Drejtësisë – Shërbimi Korrektues i Kosovës se do të jetë pjesë e vëzhgimit në ekzaminimin, vlerësimin dhe krahasimin e ofertave për aktivitetin e Prokurimit: " **Furnizim me mish dhe produkte të mishit** ".

Autoriteti Kontraktues Ministria e Drejtësisë – Shërbimi Korrektues i Kosovës e ka njoftuar Agjencinë për kohën dhe vendin e vlerësimit të ofertave dhe me këtë rast Agjencia Kundër Korrupsionit ka marrë pjesë në cilësinë e monitoruesit në procesin e ekzaminimit, vlerësimit dhe krahasimit të ofertave për këtë aktivitetin të Prokurimit më datë 03/11/2015 dhe më datë 09/11/2015.

Gjatë monitorimit të komisionit vlerësues AKK konstaton se për këtë aktivitet të prokurimit Dosjen e Tenderit e kanë dorëzuar gjithsej 3 Operatorë Ekonomik ku vetëm njëri nga këta është i **përgjegjshëm** duke i plotësuar të gjitha kriteret e kërkuara në Dosjen e Tenderit dhe në Njoftimin për Kontratë, ndërsa 2 prej tyre janë të papërgjegjshëm pasi që nuk i kanë plotësuar kriteret e kërkuara sipas Dosjes së Tenderit dhe Njoftimit për Kontratë.

Agjencia kundër Korrupsionit konstaton se konzorciumi HAJDINI COMERC&KUALITETI është i përgjegjshëm pasi që ka plotësuar të gjitha kërkesat e kërkuara në Dosjen e Tenderit.

Operatori Ekonomik BENI DONA PLAST sipas AKK është i pa përgjegjshëm pasi që pasi që nuk ka plotësuar kërkesat e përshtatshëmrisë profesionale ku kërkohet: Vërtetim nga Agjencia i Ushqimit dhe Veterinarisë (AVUK) se subjekti afarist ka të licencuar objektin për therjen e kafshëve. Gjatë monitorimit të komisionit vlerësues Agjencia ka vërejtur se Ky OE ka një kontratë me Operatorin SHPK "ABB"- Podujeve, objekti i kësaj kontrate është furnizimi me Mish si dhe therje e kafshëve për nevojat e Kompanisë SH.P.K"Beni Dona Plast". Sipas nenit 3 të kësaj kontrate Furnizuesi detyrohet që për sasinë e mishit të dërguar te kontraktuesit e shitësit të përdorë fletë dërgesat me logo të blerësit. Agjencia ka analizuar me kujdes të gjithë dokumentacionin e

ofruar nga ky OE dhe nuk ka hasur në ndonjë marrëveshje për konzorcium me OE ABB apo ndonjë dokument që vërteton se OE Beni Dona Plast ka ndonjë marrëveshje nën kontraktimi me OE ABB për këtë aktivitet të prokurimit. Bazuar në gjendjen faktike komisioni për vlerësimin krahasimin dhe ekzaminim të ofertave janë dakorduar që të kërkojnë informacione shtesë nga OE Beni Dona Plast. Mirëpo Operatorë Ekonomik BENI DONA PLAST nuk i është përgjigjur kërkesës për sqarime shtesë të kërkuara nga Autoriteti Kontraktues brenda afatit të paraparë prej pesë ditëve.

Operatori Ekonomik APETITI- Agjencia ka konstatuar oferta e këtij Operatori Ekonomik nuk është vlerësuar nga ana e komisionit vlerësuese, për faktin se më datë 19.10.2015 Autoriteti Kontraktues- Shërbimi Korrektues i Kosovës ka lëshuar Referencë me të cilën ka konfirmuar se ky OE nuk i ka kryer të gjitha furnizimet sipas kërkesave të cilat janë paraqitur për furnizim me mish dhe produkte të mishit në Qendrat Korrektuese dhe Qendrat e Paraburgimit për kontratën me nr.21500-13-015-111. Andaj ky OE është cilësuar si i papërshtatshëm për këtë aktivitet.

Si përfundim Agjencia ka konstatuar se për këtë aktivitet të prokurimit “Furnizim me mish dhe produkte të mishit” kemi vetëm një Operatorë të Përgjegjshëm.

Komisioni vlerësues pranë Autoritetit Kontraktues ka rekomanduar që të vazhdohen procedurat e prokurimit më tutje me arsyetimin si në vijim: duke u bazuar në gjendjen aktuale për mish dhe produkte të mishit mendojmë që është e udhës që të vazhdohet me këtë procedurë duke kërkuar revokimin e nenit.

Agjencia kundër Korrupsionit, konsideron se një veprim i tillë nga ana e Autoritetit Kontraktues bie ndesh me Ligjin në fuqi për Prokurimin Publik në Republikën e Kosovës nenin 32 Rregullat e Përgjithshme paragrafin 4 dhe 5. Sipas këtij neni theksohet në mënyrë decisive se nëse, gjatë zbatimit të procedurave të prokurimit, pranohen më pak se dy (2) tenderë të përgjegjshëm ose, kur është e zbatueshme, kërkesa për pjesëmarrje, autoriteti kontraktues duhet të anulojë aktivitetin e prokurimit. Pavarësisht nga kërkesat e përcaktuara në paragrafin 4 të këtij neni kur më pak se dy tender të përgjegjshëm apo kërkesa për pjesëmarrje janë dorëzuar në përgjigje të një procedure të hapur, procedure të kufizuar apo procedure të negociuar pas publikimit të njoftimit për kontratë, me kusht që *a)* specifikimet e para të kontratës nuk ndryshohen *b)* që autoriteti kontraktues ka demonstruar që për arsye të konkurrencës shumë të kufizuar në treg për kontratën në fjalë, një procedurë e re e hapur, e kufizuar ose e negociuar pas publikimit të njoftimit për kontratë nuk do të rezultoi në ngritje të numrit të tenderëve përgjegjës, kur është e aplikueshme, kërkesat për pjesëmarrje, autoriteti kontraktues mund të anuloi këtë kërkesë. Komisioni Rregullativ për Prokurimin Publik, duhet të njoftohet nga autoriteti kontraktues përkatës brenda dy ditëve nga dita e vendimit për anulimin e kërkesës. Mirëpo pavarësisht se LPP lejon revokimin e kërkesës me më pak se dy tender të përgjegjshëm, megjithatë në rastin konkret Autoriteti Kontraktues nuk ka demonstruar se ekziston një konkurrencë shumë e kufizuar për këtë lloj furnizimi dhe fakti se gjatë zhvillimit të kësaj procedure të prokurimit ka pasur 4 Operator ekonomik të cilët e kanë tërhequr dosjen për këtë tender dhe kanë ofertuar 3 prej tyre, tregon

shumë qartë se ka numër të mjaftueshëm të Operatorëve ekonomik të interesuar që bëjnë furnizimet e tilla.

Veprimet e Autoritetit Kontraktues të cekura më lartë, konsiderojmë se bien ndesh me Nenin 32 Rregullat e Përgjithshme të Ligjit për Prokurimin Publik.

Konsiderojmë se shkelje të tilla, nuk duhet lejuar në procedura të prokurimit, andaj AKK rekomandon anulimin e kësaj procedure të prokurimit dhe të shmangen praktika të tilla në të ardhmen.

Autoriteti Kontraktuese e informon Agjencinë për veprimet e ndërmarra.

Me respekt !

